



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 100, datë 31.05.2023

PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË Z. VASIL PILO NË POZICIONIN E KRYETARIT
DHE ZJ. ANILA IBRAJ, NË POZICIONIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT
MBIKQYRËS TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “INSIG JETË” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Riemërimin e z. Vasil Pilo, në pozicionin e kryetarit dhe zj. Anila Ibraj, në pozicionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë së Sigurimit “Insig Jetë” sh.a., për një periudhë 3 vjeçare.**
- 2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Idlir GJATA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE